



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KUVENDI

Komisioni për Çështjet Ligjore, Administratën Publike dhe të Drejtat e Njeriut

PROCESVERBAL

Tiranë, më 22.11.2021, ora 11:30

Drejton mbledhjen:

Klotilda Bushka – kryetare e Komisionit

Rendi i ditës:

1. Shqyrtimi i projektligjit “Për disa shtesa në ligjin nr.99/2021 “Për ratifikimin e vendimit të komitetit të përbashkët EFTA–Shqipëri nr. 1 i vitit 2021, miratuar më 24.6.2021, për ndryshimin e protokollit B të marrëveshjes së tregtisë së lirë, ndërmjet shteteve të EFTA-s dhe Republikës së Shqipërisë, lidhur me përkufizimin e konceptit të “produkteve origjinuese” dhe metodat e bashkëpunimit administrativ, dhe ndryshimi i marrëveshjeve për bujqësinë ndërmjet Republikës së Shqipërisë dhe Konfederatës së Zvicrës, dhe Republikës së Shqipërisë dhe Republikës së Islandës, si pjesë përbërëse e saj””.

Marrin pjesë:

Klotilda Bushka, Klevis Xhoxhi, Saimir Hasalla, Denis Deliu, Fatmir Xhafaj, Eduard Ndreca, Oerd Bylykbashi, Enkelejd Alibeaj, Saimir Korreshi, Greta Bardeli, Dashnor Sula, Fatmir Mediu, Aurora Mara, Gerta Duraku, Toni Gogu, Gledis Çeliku, Bledion Nallbati, Ermonela Valikaj(Felaj), Dhurata Tyli, Bardhyl kollcaku.

Mungojnë:

Damian Gjikhuri, Jurgis Çyrbja, Erisa Xhixho, Xhemal Qefalia, Gazmend Bardhi, Elda Hoti,

Të ftuar:

Besart Kadia - Zëvendësministër i Financave dhe Ekonomisë

Arjana Dyrmishi - Drejtore e Drejtorisë së Politikave të Zhvillimit Ekonomik në Ministrinë e Financave dhe Ekonomisë

Vjosana Neziri - Drejtore e drejtorisë juridike

HAPET MBLEDHJA

Klotilda Bushka – Mirëdita, të nderuar kolegë!

Fillojmë mbledhjen e datës 22 nëntor të Komisionit të Ligjeve, me rendin e ditës që ju është njoftuar.

Në rendin e ditës janë dy çështje, por sot do të diskutojmë vetëm një të njërën prej çështjeve, konkretisht, shqyrtimin e projektligjit “Për disa shtesa në ligjin nr.99/2021 “Për ratifikimin e vendimit të komitetit të përbashkët EFTA–Shqipëri nr.1 i vitit 2021, miratuar më 24.6.2021, për ndryshimin e protokollit B të marrëveshjes së tregtisë së lirë, ndërmjet shteteve të EFTA-s dhe Republikës së Shqipërisë, lidhur me përkufizimin e konceptit të “produkteve origjinuese” dhe metodat e bashkëpunimit administrativ, dhe ndryshimi i marrëveshjeve për bujqësinë ndërmjet Republikës së Shqipërisë dhe Konfederatës së Zvicrës, dhe Republikës së Shqipërisë dhe Republikës së Islandës, si pjesë përbërëse e saj”. Komisioni ynë është komision për dhënie mendimi. Relator është zoti Saimir Hasalla.

Kanë konfirmuar pjesëmarrjen zoti Besart Kadia, zëvendësministër i Financave dhe Ekonomisë, zonja Arjana Dyrmishi, drejtore e Drejtorisë së Politikave të Zhvillimit Ekonomik në Ministrinë e Financave dhe Ekonomisë dhe zonja Vjosana Neziri, drejtore e drejtorisë juridike.

Mirë se erdhët!

Kalojmë në prezantimin e aktit.

Zoti zëvendësministër, fjala është për ju.

Mirë se erdhe, zoti Kadia!

Besart Kadia – Faleminderit!

Përshëndetje, të nderuar deputetë!

Siç u tha dhe pak më parë, bëhet fjalë për projektligjin për ratifikimin e vendimit të komitetit të përbashkët EFTA–Shqipëri. Projektligji i propozuar sot lidhet me amendimin e këtij ligji, duke shtuar, sipas pjesës përbërëse të marrëveshjes së EFTA-s, dhe marrëveshjen në fushën e bujqësisë me palën norvegjeze.

Faktikisht, marrëveshja me palën norvegjeze është nënshkruar në datën 8 korrik 2021. Kjo marrëveshje dypalëshe për bujqësinë ndërmjet Shqipërisë dhe Norvegjisë, si pjesë përbërëse e marrëveshjes së tregtisë së lirë EFTA, miraton ndryshimet për përkufizimin e konceptit të “produkteve origjinuese” dhe metodat e bashkëpunimit administrativ dhe

marrëveshjes dypalëshe për bujqësinë, ndërmjet Shqipërisë, Konfederatës së Zvicrës dhe Islandës.

Faktikisht, kjo marrëveshje amendon nenin 3 të marrëveshjes bazë, të lidhur me rregullat e origjinës dhe bashkëpunimin administrativ. Ky amendim konsiston në faktin se rregullat e origjinës për produktet bujqësore do të jenë sipas protokollit B të marrëveshjes bazë të tregtisë së lirë.

Duhet theksuar se aplikimi i këtyre rregullave tranzitore do të jetë fakultativ dhe do të vazhdojë paralelisht me rregullat ekzistuese.

Administrata jonë doganore është duke zhvilluar takime me përfaqësuesit e biznesit, duke informuar mbi këto rregulla tranzitore, për njohjen e tyre dhe shfrytëzimin e mundësisë për t'i përdorur ato.

Zbatimi i rregullave të origjinës që po ndryshohen nuk ka efekte financiare të drejtpërdrejta në buxhetin e shtetit.

Zbatimi i rregullave të origjinës të ndryshuara vlerësohet të sjellë efekte pozitive, por që nuk do të vlerësohen, për arsye se miratimi i rregullave tranzitore u jep mundësi bizneseve të operojnë në tregjet e vendeve partnere, për të përfituar nga masat e politikave tregtare.

Rregullat do të lehtësojnë dhe do të zhvillojnë më tej tregtinë e ndërsjellë ndërmjet vendeve pjesëmarrëse.

Në rast se doni një informacion paraprak, për sa u përket shkëmbimeve tregtare me Norvegjinë, ato janë akoma në nivele të ulëta, gati të papërfillshme. Për vitin 2021 vlera ka qenë 445 mijë euro, por, gjithsesi, është në rritje krahasuar me vitet e mëparshme.

Ky projektligj i ndihmon bizneset shqiptare ta kenë më të lehtë eksportimin ndaj vendeve që janë pjesë e EFTA-s.

Ju faleminderit!

Klotilda Bushka – Faleminderit, zoti Kadia!

Po, zoti Hasalla.

Saimir Hasalla – Faleminderit!

Në fakt, sot po sjellim për shqyrtim projektligjin për disa shtesa në ligjin nr.99/2021, për ratifikimin e vendimit të komitetit të përbashkët EFTA–Shqipëri. Ky projektligj është nismë e Këshillit të Ministrave, mbështetur në nenet 78 e 83, pika 1, dhe në nenin 121, pika 1, të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë.

Ne, si Komision për Çështjet Ligjore, Administratën Publike dhe të Drejtat e Njeriut, e shqyrtojmë këtë projektligj në cilësinë e komisionit për dhënie mendimi, bazuar në nenet 32 dhe 38 të Rregullores së Kuvendit.

Qëllimi i këtij projektligji është ratifikimi i ndryshimit të marrëveshjes për bujqësinë, ndërmjet Republikës së Shqipërisë dhe Mbretërisë së Norvegjisë, e cila është pjesë përbërëse e vendimit të komitetit të përbashkët EFTA-Shqipëri. Marrëveshja dypalëshe për bujqësinë, ndërmjet Republikës së Shqipërisë dhe Mbretërisë së Norvegjisë, si pjesë përbërëse marrëveshjes së tregtisë së lirë EFTA-Shqipëri, është miratuar në parim me vendimin nr.323, datë 2.6.2021, të Këshillit të Ministrave, që miratoi vendimin e komitetit të përbashkët EFTA-Shqipëri për ndryshimin e protokollit B, lidhur me përkufizimin e konceptit të “produkteve origjinuese” dhe metodat e bashkëpunimit administrativ, dhe marrëveshjeve dypalëshe për bujqësinë ndërmjet Republikës së Shqipërisë dhe Konfederatës së Zvicrës, dhe Republikës së Shqipërisë dhe Islandës.

Duke qenë pjesë përbërëse e marrëveshjes bazë, me qëllim që rregullat e alternativës së origjinës preferenciale të mund të zbatohen ndërmjet shteteve të EFTA-s, nga njëra anë, dhe Shqipërisë, nga ana tjetër, për produktet me origjinë nga palët, duhet që protokollin B, lidhur me përkufizimin e konceptit të “produkteve origjinuese” dhe metodat e bashkëpunimit administrativ, të zbatohet edhe për Norvegjinë, dhe ligjit nr.99/2021 duhet t'i shtohet marrëveshja dypalëshe për bujqësinë Shqipëri-Norvegji.

Zbatimi i rregullave të origjinës të ndryshuara vlerësohet të sjellë efekte pozitive, por që nuk mund të vlerësohen, për arsye se miratimi i rregullave tranzitore u jep mundësi bizneseve të operojnë në tregjet e vendeve partnere për të përfituar nga masat e politikave tregtare. Rregullat do të lehtësojnë dhe zhvillojnë më tej tregtinë e ndërsjellë ndërmjet vendeve pjesëmarrëse.

Zbatimi i rregullave të origjinës që po ndryshohen me anë të këtij projektligji nuk ka efekte financiare në buxhetin e shtetit.

Projektligji është në përputhje me Kushtetutën e Republikës së Shqipërisë, si dhe ka respektuar kërkesat e Rregullores së Kuvendit për paraqitjen e tij në Kuvend.

Ndaj, ftoj kolegët ta miratojnë këtë projektligj.

Klotilda Bushka – Faleminderit, zoti Hasalla!

Ne jemi komision për dhënie mendimi dhe, në përputhje me atë që shqyrtojmë, e kuptojmë që jemi për t'u shprehur pro përputhshmërisë së tij me Kushtetutën dhe aktet, por do të doja të kuptonim pak më qartë për publikun se për çfarë bëhet fjalë. Prandaj kam nja dy pyetje.

Sot ne diskutojmë këtu një projektligj për të shtuar, pra në ligjin për ratifikimin e vendimit të komitetit të EFTA-s, marrëdhënies së tregtisë së lirë të EFTA-s me Shqipërinë, do të bëjmë disa ndryshime në lidhje me çfarë quhen “produkte të origjinës”, ose këto ndryshime janë të bëra dhe ne i kemi miratuar më parë.

Për sa u takon dy shteteve, Zvicrës dhe Islandës, ne nuk kemi pasur akte. Për këtë arsye po përfshihen edhe këto në të njëjtin regjim? Në qoftë se e kam kuptuar drejt.

A mund të ma sqaroni, ju lutem, që ta kuptojmë se për çfarë jemi duke folur në thelb?
(Ndërhyrje pa mikrofon)

Po, e drejtë. Pra, po shtojmë shtetet apo po ndryshojmë definicionin e “produktit të origjinës”? Sepse, me sa mbaj mend në legjislaturën e kaluar, e kemi miratuar se çfarë është “produkt origjine”.

Fjala për ju, zonja.

Arjana Dyrmishi – Jam Arjana Dyrmishi nga Ministria e Financave dhe Ekonomisë.
Faleminderit!

Nga fundi i vitit të kaluar dhe gjatë këtij viti, të gjitha shtetet anëtare të konventës PEM, kanë rinegociuar marrëveshjen e tregtisë së lirë, në të cilën kanë ndryshuar protokollin e origjinës. Ky është protokollin e origjinës, i cili tregon kur përfitohen produktet, origjina, për të përfituar nga masat preferenciale.

Në seancën e fundit të parlamentit, ne miratuam ndryshimin e marrëveshjes, protokollin e origjinës me BE-në, CEFTA-n dhe EFTA-n. Me EFTA-n e miratuam për të gjitha produktet industriale, për të gjitha vendet e EFTA-s, Islandën, Norvegjinë dhe Zvicrën, ndërkohë dhe produktet bujqësore të Islandës dhe të Zvicrës.

Norvegjia nuk arriti ta nënshkruante në kohë këtë marrëveshje, më 24 shtator, pra vetëm për ndryshimin e bujqësisë. Kishte probleme me plotfuqishmërinë, se po merrej me UK-ën në atë kohë dhe e nënshkroi më 8 korrik.

Kështu që, në pamundësi për ta sjellë më parë, se u mbyll seanca plenare, e sollëm tani.

Këtu sjellim vetëm ndryshimin e marrëveshjes që kemi me produktet bujqësore me Norvegjinë, sepse vetë marrëveshja e EFTA-s, kur është miratuar atëherë, është miratuar komiteti i përbashkët, rregullat e përbashkëta me EFTA-n, si dhe pjesë e kësaj marrëveshjeje të tregtisë së lirë kanë qenë dhe tri marrëveshjet në fushën e bujqësisë, me Islandën, Zvicrën, Norvegjinë. Dy të parat e firmosën me plotfuqishmëri në datën 24 qershor, ndërsa më 8 korrik u shtua dhe Norvegjia. Pra, ne sot shtojmë dhe produktet bujqësore me Norvegjinë, duke amenduar nenin 3 të marrëveshjes me bujqësinë, lidhur me njohjen e rregullave të origjinës. Bashkëlidhur është nënshkruar që neni 3, i cili përcakton rregullat e origjinës, produktet bujqësore ndërmjet dy palëve, zëvendësohet dhe i bashkëlidhet protokollin B, ai që është miratuar me vendimin e komitetit.

Këtë jemi munduar të sqarojmë dhe në relacion, i cili ka dalë pak i gjatë.

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Klotilda Bushka- Pra, për Islandën ne e kemi të miratuar, Norvegjia shtohet, por për efekt se ka qenë në titull mbetet dhe Islanda sot.

Arjana Dyrmishi – Po, edhe Zvicra, zonja kryetare.

Klotilda Bushka- Po, edhe Zvicra, e drejtë.

Zonja Çupi ka pyetje.

(Zonja Çupi flet pa mikrofon)

Dhurata Çupi – Faleminderit!

Së pari, do të kërkoja të kishte përfaqësues nga Ministria e Bujqësisë, sepse deputetët kanë të drejtë ta zgjerojnë edhe përgjigjen e pyetjes që bëjnë ose atë çfarë kërkojnë.

Çfarë prodhimesh bujqësore me origjinë shqiptare eksportojmë ne, që shkojnë në Norvegji dhe në Zvicër?

Çfarë marrim ne nga ata?

Faleminderit!

Klotilda Bushka- Po, zoti Kadia.

Besart Kadia – Faleminderit për pyetjen!

Këto janë marrëveshje të tregtisë së lirë, të cilat janë për produktet e origjinës. Ajo që ndihmon bizneset shqiptare është që në rast se do të marrin produkte nga vendet e tjera, të mund t'i përpunojnë në Shqipëri dhe të marrin certifikimin që janë me origjinë shqiptare dhe të kenë kushte preferenciale drejt eksportimit.

Pak më parë thamë që shkëmbimet tregtare me shtete si Norvegjia janë të pakta, pra me vlerë 445 mijë euro, sipas të dhënave të fundit për vitin 2021. Kjo marrëveshje mundëson lehtësinë institucionale për të mundësuar eksportimin.

Për sa u përket produkteve, duke qenë se është një vlerë e vogël, besoj se mund t'ju japim përgjigje pasi t'i shohim më në detaje zërat. Duke qenë se për momentin nuk është ndonjë vlerë e madhe, nuk besoj se ka shumë llojshmëri produktesh.

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Për bujqësinë nuk besoj se është e rëndësishme, sepse po flasim për marrëveshje ndërkombëtare dhe në këtë rast nuk është specifike Ministria e Bujqësisë.

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Klotilda Bushka – Në fakt, zonja Çupi e bëri pyetjen të qartë. Në qoftë se ju nuk i përgjigjeni dot, nuk ka problem, sepse mund t'ia marrim përgjigjen me shkrim ministrisë.

E ka kërkuar fjalën për pyetje zoti Sula, zoti Nallbati dhe zoti Alibeaj.

Po, zoti Sula.

(Zoti Sula flet pa mikrofon)

Pyetja e zotit Sula është nëse kjo marrëveshje ka kosto financiare për buxhetin e shtetit.

Besart Kadia – Kosto financiare nuk ka. Ideja është që ka vetëm përfitime.

Klotilda Bushka - Po, zoti Nallbati.

Bledjon Nallbati – Kam një pyetje për përfaqësuesit e Ministrisë së Financave dhe po shfrytëzoj rastin meqenëse janë këtu.

Ne jemi të angazhuar për të ratifikuar një marrëveshje ne vendet e EFTA-s, kur ndërkohë shkëmbimet tregtare ishin shumë të vogla, pra, me sa shikoj, përfitimi nuk është shumë i madh.

Dua të di se përse ne nuk jemi të angazhuar për një marrëveshje me vendet e Lindjes së Mesme, kryesisht me Egjiptin, me të cilin mund të bëjmë shkëmbime tregtare në fushën e bujqësisë, në nivele shumë të vlefshme. Nëse jemi të angazhuar, deri ku jemi?

Faleminderit!

Klotilda Bushka – Faleminderit, zoti Nallbati!

Po, zoti Kadia.

Besart Kadia – Po ia kaloj fjalën zonjës Dyrmishi për këtë pyetje.

Arjana Dyrmishi – Për negocimin e marrëveshjeve të reja me vende si Egjipti dhe të tjera, duhet të ketë një kërkesë të artikuluar nga komuniteti i biznesit dhe nga institucionet për nevojshmërinë e saj.

Në disa diskutime, e kam të dëgjuar si nevojë, që ka dalë për produkte specifike, mirëpo asnjëherë nuk është artikuluar me një qëndrim zyrtar për lidhjen e një marrëveshjeje të tillë.

Negocimi i një marrëveshjeje të tillë të tregtisë së lirë, së pari, duhet të formalizohet pranë Ministrisë së Financave dhe Ekonomisë dhe formalizimi i kësaj kërkesë për nevojshmërinë e marrëveshjes së tregtisë së lirë duhet të jetë e argumentuar me interesat dhe janë interesat ekonomikë. Kjo për arsye, sepse në një marrëveshje të tillë kuptohet ka të bëjë me një koncesion, pra, unë do të kërkoj të jap diçka palës egjiptiane, ose të një vendi tjetër në këmbim të asaj se çfarë do të na ofrojnë ata. Ne nuk e kemi pasur, të paktën në dijeninë time, nuk kanë pasur një artikulum të tillë institucional nga një dhomë tregtie, nga një përfaqësi biznesi, ose nga një institucion.

Klotilda Bushka –Po, zoti Nallbati.

Në dijeninë time, ka pasur kërkesë zyrtare dhe, meqenëse sot ka një takim në Ministrinë e Bujqësisë, ku janë thirrur grumbulluesit e produkteve bujqësore për këtë arsye. Kështu që nuk është e vërtetë që nuk ka një iniciativë, sepse ka një iniciativë zyrtare të kërkuar prej disa vitesh. Unë nuk e di pse nuk ecën përpara kjo iniciativë.

Për sa i përket pjesës së shkëmbimeve, sigurisht që ashtu funksionon dhe ata, unë duke qenë i interesuar për zonën time që përfaqësoj, Egjipti kryesisht ka interes për Mollët e qarkut të Korçës, ndërkohë që ne importojmë nga ata sasi të vogla patate farë apo fasules. Kështu që interesi për shkëmbime tregtare është nga të dy vendet, ose më saktë nga të dy komunitetet, nga komuniteti prodhues atje dhe nga komuniteti prodhues këtu dhe interes unë nuk shoh vetëm nga qeveria që nuk angazhohen. Unë dua të the, edhe një fakt që ju ta keni të qartë dhe ndoshta ju shtyn që të angazhoheni pak. Prodhimi i mollës në zonën e Korçës kap vlerën e 50 milionë eurove, të cilat jo më shumë e 50% e tyre përkthehen në të ardhura dhe pjesa tjetër shkon dem vetëm për një marrëveshje me këto vende, të cilat kanë kërkesë shumë të lartë.

Klotilda Bushka – Zoti Nallbati, faleminderit!

Në fakt, Ministria e Financave këtu ndoshta nuk mund t’ju japë dot përgjigje kërkesës suaj, por meqenëse Ministria e Bujqësisë është përgjegjëse...

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Zoti Nallbati, nuk është nevoja të ngrini zërin, sepse ju dëgjoj shumë mirë, por ju shpjegoj që Ministria e Bujqësisë jam e sigurt që i ka këto çështje në prioritet, ku, aq më tepër, edhe ju vetë thoni që ka një takim në lidhje me këtë çështje paralelisht dhe atje mund të interesoheni dhe të shihni nëse ka një interes për të rritur shkëmbimet midis dy vendeve dhe t’ia kërkojmë, si komision, duke adresuar shqetësimet e banorëve, por të jeni të sigurt që mendoj që e ka në prioritet ministria për sa kohë ju vetë jeni informuar që ka një mbledhje.

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Zoti Alibeaj, fjala për ju.

Enkelejd Alibeaj- Faleminderit, zonja kryetare!

Të gjitha debatet që po bëhen nga kolegët e kanë një shkak. Cili është shkak?! Shkak është i thjeshtë. Në Kuvendin e Republikës së Shqipërisë, në Komisionin e Ligjeve, por edhe në komisionet e tjera sa herë vijnë praktikantët e ratifikimit të marrëveshjeve dokumentacioni vjen i mangët. Ne sot kemi vetëm dy dokumente, projektligjin dhe relacionin, ndërkohë këtu me të vërtetë pala qeveritare thotë që s’ka nevojë të jetë Ministria e Bujqësisë, por që, në fakt, ajo është implementuesja dhe për arsye se sasia e parave të angazhuara janë të pakta deri tani, dakord, po Ministria e Financave çfarë lidhje ka? Ndërkohë ju kujtoj, meqenëse jeni përfaqësues të qeverisë, që procedura e ratifikimit të një marrëveshjeje ndërkombëtare bazohet në një ligj kuadër, ligji 43 i vitit 2016. Ky ligj përcakton edhe aspektin procedural sesi do të vijohet iteri procedural për miratimin e këtyre dhe dokumentacione shoqëruese. Neni 17 pika 3 e atij ligji thotë këtë gjë: “Ratifikimi i marrëveshjeve ndërkombëtare bëhet nga Kuvendi. Projektligji, ky që na keni sjellë dhe na është shpërndarë, duhet të shoqërohet me dokumentet

e parashikuara në pikën dy të këtij neni dhe po i citoj: “Projektligji për ratifikim, e kemi. Projektvendimi për propozimin e projektligjit, nuk e kemi. Vendimi i miratimit në parim; nuk e kemi. Tekstet e marrëveshjes së nënshkruar në gjuhën shqipe dhe angleze ose përkthimi i certifikuar, kjo e dyta nuk është. Relacioni shpjegues, sipas parashikimeve të pikës 4, të nenit 8, e kemi, por duhet referim te neni 8 pika 4. Mendimi i Ministrisë së Punëve të Jashtme dhe i Ministrisë së Drejtësisë për përmbajtjen e projektligjit, nuk e kemi.

Kalojmë te dispozita tjetër. Në nenin 8 pika 4, atë se çfarë duhet të përmbajë relacioni, thuhet disa gjëra të rëndësishme, të cilat duhet të kishin davaritur çfarëdolloj diskutimi të ngritur edhe nga kolegu Nallbati. Çfarë duhet të përmbajnë?! Arsyen, qëllimin, objektin; përparësitë dhe rezultatet e pritshme. Ja pra pse ngrihet problemi nga kolegu Nallbati, sepse në një vlerësim krahasues thotë me të drejtë që pse po e lidhim ne me Norvegjinë kur janë vetëm 450 mijë euro në total. Ndërkohë ka kërkesë, sipas informacionit që kolegu thotë, nga Egjipti, që mund të ishte shumëfish përfitimi i sferës së bujqësisë shqiptare. një pikë tjetër e këtij neni është efektet financiare që rrjedhin nga zbatimi i saj, si dhe evidentimin dhe arsyet e marrjes së masave të nevojshme ligjore për zbatimin e marrëveshjes. Ja, pra, pikërisht mungesa në tavolinën e deputetëve të të gjithë dokumentacionit që në gjenezë për inicimin e lidhjes së një marrëveshjeje i vendos deputetët e Kuvendit në pamundësi për të vlerësuar a është prioritare apo nuk është prioritare, a është bërë për qokë apo është në funksion të realizimit të programit qeveritar dhe nevojave që ka publiku, qytetari, biznesi. Ja pra kjo është një mangësi, e cila është bërë dhe bëhet në mënyrë sistematike në parlamentin shqiptar. E mira do të ishte që ju, si palë qeveritare, dhe e keni detyrim në bazë të ligjit, që të gjithë korrespondencën që nga pika zero, që kur ka lindur ideja për të lidhur një marrëveshje ndërkombëtare t’u silllet edhe deputetëve, në mënyrë që të jemi në gjendje për të vlerësuar nëse është e mirë apo nuk është e mirë, funksionon apo nuk funksionon, është në favor të qytetarëve apo jo. Fakti që vendos gjithçka në errësirë lë për këdo mundësinë të dyshojë. Ja pra, kërkesa ime, edhe procedurale po të doni në këtë rast, është të zbatoni detyrimin ligjor, sillni të gjithë dokumentacionin korrespondencën që keni pasur deri në këto momente dhe pastaj të vlerësojmë. Nëse është vërtetë në funksion të qytetarëve, do të keni pro votën tonë, por, nëse është thjesht dhe vetëm për fasadë, nëse është thjesht dhe vetëm për të mbushur kalendarin vjetor të miratimit të akteve ligjore me zero përfitim, kjo jo vetëm që është tallje për deputetët, por edhe për qytetarët. Ky është detyrim ligjor që duhet ta përmbushni ju dhe, nëse nuk e përmbushni, kërkesa vjen që komisioni ynë apo komisioni përgjegjës ta kërkojë këtë gjë.

Faleminderit!

Klotilda Bushka- Faleminderit, zoti Kadiu!

Besart Kadiu –Faleminderit!

Zoti deputet, ajo që thatë ju pak më parë për rëndësinë e Ministrisë së Bujqësisë, dua të theksoj edhe një herë që kjo është marrëveshje e tregtisë së lirë dhe ka të bëjë me rregullat e doganës, të cilat interpretojnë rregullat e origjinë. Pra, Ministria e Bujqësisë nuk e ka të nevojshme dhe as për detyrë që të merret me këtë pjesë, pra me interpretimin e produktit të origjinës, të cilin e ka vetëm dogana. Ajo që thatë ju pak më parë për sa u përket dokumenteve, unë dua t'ju them që të gjitha që ju përmendet janë bërë dhe janë të bëra. Çështjet administrative, nëse janë printuar ose jo për t'jua vënë juve në dispozicion, nuk di të them, por mendoj se për pak minuta sekretaria mund t'ju vërë në dispozicion dhe të bindeni që nuk është fasadë, sepse janë me qindra faqe letrash të punuara dhe të bëra gati dhe po të keni kohë mund t'i lexoni.

Klotilda Bushka- Zoti Alibeaj, dua t'ju shpjegoj diçka. Kur është njoftuar rendi i ditës ju ka ardhur teksti i projektligjit, vendimi i Këshillit të Ministrave që kalon projektligjin, relacionet përkatëse, teksti i marrëveshjes së ndryshuar, i përkthyer në shqip sipas autorizimit dhe në relacionin që shoqëron projektligjin keni edhe mendimet e ministrive. Nuk e di se çfarë mungon?! Të printuar këtu nuk keni, sepse ju e dini se si rregull është që këtu printohen 5 kopje në dhe formë elektronike ju vijnë të gjitha materialet. Në qoftë se nuk i keni lexuar, mund të na thoni që t'jua printojmë dhe t'jua japim, por, sa i takon pjesës procedurale, unë mendoj që administrativisht është në përputhje me sa i takon ligjit e gjithë procedura e kateve të njoftuara, ndërsa, sa i takon pjesës së thelbit, ju keni të drejtë të kërkoni çdo lloj informacioni për çështjen.

Ankelejd Alibeaj- Ta sqaroj, sepse nuk e thashë për debat, por, nëse ju i kaloni në situata të tilla që nuk i kemi lexuar apo nuk i kemi kuptuar, kjo nuk është dinjitoze për askënd. Çfarë ka printuar administrata, s'dua ta ngarkoj administratën, sepse nuk kanë faj?! Këtu ka vetëm një projektligj dhe një relacion, asgjë më tepër. Unë jua citova se cilat janë dokumentet që duhet të jenë si detyrim ligjor, jo si oportunitet juaji. Nëse ju thoni që i keni sjellë, por Kuvendi nuk i shpërndan, kjo është një tjetër histori dhe duhet ta sqarojmë, sepse nuk jam fare për t'ju ngarkuar me barrë.

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Deputeti i Kuvendit të Shqipërisë ka nga faqja 1-7, asgjë tjetër. Ku është mendimi i Ministrisë së Drejtësisë dhe i Ministrisë së Jashtme? Ku është vlerësimi që është bërë për përfitimet? Këto janë dokumentet, me të cilat do të duhet të diskutojmë ne dhe është e udhës, nëse qeveria e ka bërë, zonja kryetare, që ta bëni edhe ju dhe t'ua shpërndani të gjithë deputetëve. Mund ta bëni verifikimin në këtë rast, sepse duke e çuar këtë si një gabim të vogël

administrativ, i vendosni deputetët në kushte të tilla, që duke mbyllur sytë, ngre dorën dhe kjo nuk është dinjitoze për askënd.

Klotilda Bushka –Zoti Alibeaj, nuk është fare kështu. Ju po e thoni siç e mendoni ju, por, në fakt, kur vjen vendimi i Këshillit të Ministrave që kalon marrëveshja, të gjitha mendimet e ministrave të linjës janë atje dhe nuk vijnë të gjitha këtu. Kur vjen vendimi i Këshillit të ministrave, sipas ligjit për organizmin e Këshillit të Ministrave, ka një procedurë. Çfarë do të bëjmë ne këtu, do t'i mësojmë njëri-tjetrit si është procedura?! Kur vjen vendimi i Këshillit të Ministrave janë marrë mendimet, por, nëse ju doni më shumë informacion, jua paraqesim të gjitha. Akti që është miratuar në qeveri vjen me ligjin përkatës, relacionin dhe të gjitha informacionet, por, nëse doni më shumë informacion, patjetër, mund të na thoni. Ka kaluar në filtra dhe të gjitha dokumentet nga na administrative janë në rregull. Në thelb, hajdeni ta diskutojmë.

Enkelejd Alibeaj- Projektligji është ky dhe po e citoj për të mos bërë asnjë lloj debati: “Projektligji, i shoqëruar me dokumentet e parashikuara në pikën 2, të këtij neni, pas miratimit nga Këshilli i Ministrave, i kalon për ratifikim Kuvendit”. Në pikën 2 të nenit 17 janë paraqiten dokumentet që duhen, të cilat janë: a) projektligji për ratifikim; b) projektvendimi për propozimin e projektligjit; c) vendimi i miratimit në parim; ç) tekstet e marrëveshjes së nënshkruar në gjuhën shqipe dhe angleze, të cilat nuk janë...

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Ma trego dhe ju kërkoi unë ndjesë.

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Anglisht, zonjë. Tekstet e marrëveshjes së nënshkruar në gjuhën shqipe dhe angleze duhet të jenë këtu.

d) mendimi i Ministrisë së Punëve të Jashtme dhe i Ministrisë së Drejtësisë për përmbajtjen e projektligjit.

Këto janë të rëndësishme për Kuvendin. Veprimtaria e qeverisë kontrollohet nga Kuvendi.

Klotilda Bushka- Ju lutem, sekretaria, të printojë një set të të gjithë praktikës që ka ardhur në Kuvend dhe që u është shpërndarë deputetëve, sepse zoti Alibeaj nuk i ka. Sekretaria t'i japë zotit Alibeaj të gjithë praktiken që e ka në emaili dhe nuk e ka printuar.

Enkelejd Alibeaj- Mos e trajtoni me kaq padinjitet këtë histori, sepse është respekt për Kuvendin për të përmbushur funksionin që ka, atë të kontrollit ndaj qeverisë. Është kaq e thjeshtë.

Klotilda Bushka- Zoti Alibeaj, jeni duke bërë një debat, i cili, siç thotë një shprehje e vjetër: “Këndon letra. La Carta Canta”. Do ta printojmë praktikën nga emaili, merreni dhe lexojeni dhe mos harxhoni kohë kot.

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Jo, ne të tjerët jemi të qartë. Pse nuk i keni lexuar ju aktet, nuk do të shtyjmë mbledhjen.

Besart Kadiu- Zoti Alibeaj, unë ju dëgjova me vëmendje dhe e thatë edhe më parë që është e rëndësishme që të respektohen rregullat ligjore. Ne ju garantojmë dhe jua japim edhe në çast, sepse kemi disa kopje, për t’ju vërtetuar që ekzistojnë. Në qoftes e keni dëshirë, është në diskrecionin tuaj të zgjidhni pjesën e dokumenteve. Pra, në rast se argumenti është janë apo jo, unë ju garantoj që janë të gjitha detyrimet ligjore që ju përmendet. Çështjen sesi do t’jua japin personalisht juve tani, nuk është në...

Klotilda Bushka- I njoftoj kolegët që përveçse i kanë në emaile, i kanë edhe në faqen e Kuvendit të gjitha aktet e botuara. Kështu që jemi duke bërë një debat shterpë.

Zoti Bylykbashi, a keni diçka për të shtua? Në të kundërt kalojmë në votim

Oerd Bylykbashi- Unë po marr shkas nga ajo që tha zoti Alibeaj. Në fakt, vë në pah një problem që ne kemi jo vetëm për këtë projektligj, pasi është në përgjithësi me procesin legjislativ të këtij Kuvendi. Gjykoj që është në nivele afër të papranueshmes mënyra sesi hyjnë dhe kalojnë ligjet në parlamentin e Republikës së Shqipërisë. Shpejtësia me të cilën hynë dhe shpeshherë këto lloj dokumentesh, siç janë marrëveshjet dhe në këtë kualitet të njohjes që marrim ne jo vetëm koha shumë e shkurtër, dokumentacioni është pothuajse e pamundur të konsultohet në kohë të mjaftueshme për të arritur në konkluzione. Rasti konkret mund të jetë shumë i thjeshtë, madje unë shoh që Norvegjia i ka dhënë rëndësi, sepse ka marrë kohën dhe s’ka pritur, ndërkohë që ne po nxitojmë te ky rast dhe te rastet e tjera. Domethënë, është një rast legjislativ, i cili i bën deputet[et e Republikës së Shqipërisë të pamundur të thellohen, të marrin shqyrtim, të marrin kohën e tyre, të bëjnë debatin e nevojshëm që ligje të rëndësishme, ato që janë me shumicë të cilësuar, por edhe këto marrëveshje, që janë po aq të rëndësishme, nëse është e nevojshme, t’i kthejmë mbrapsht, madje edhe t’i rrëzojmë. Pra, është pamundësia që të vendosin deputetët. Unë nuk besoj se ndani opinione të ndryshme. Kjo është traditë, për fat të keq, e konsoliduar, por jo në mënyrën e duhur. Na duhet t’i japim kohën vetes, të miratohen, të futen në program, të futen në kalendar dhe brenda javës duhet të jenë në seancë, sepse, përndryshe, qeveria i do. Pra, qeveria arrin në atë pikë sa e konsideron thjesht një vendosje vule mbi aktet dhe kjo dëmton procesin legjislativ, dëmton edhe dinjitetin e Parlamentit të Republikës së Shqipërisë përballë jo vetëm të qeverisë, por edhe përballë opinionit publik, apo partnerëve tanë që janë përballë nesh.

Unë nuk dua të zgjatem, por dua të nënvizoj diçka. Jam i sigurt që edhe ju, kush ka eksperiencë parlamentare të vjetër, ky është një problem, i cili duhet marrë në konsideratë. Deputetët nuk janë vulë e njomë për të kaluar çdo marrëveshje apo çdo ligj që vjen me nxitim nga qeveria.

Faleminderit!

Klotilda Bushka- Faleminderit, zoti Bylykbashi!

Po, zonja Felaj.

Ermonela Felaj- Faleminderit!

Kam përshtypjen se me këtë pikë të rendit të ditës u ngrit një stuhi në gotë, sepse marrëveshja me EFTA-n është një marrëveshje e tregtisë së lirë, që, natyrisht, nuk është kompetencë e këtij komisioni dhe as e parlamentit, sepse e ka qeveria kompetencën që të bëhet kjo marrëveshje. Kjo është jo vetëm praktikë parlamentare, por praktikë ligjore e njohur, që ne nuk i hymë, absolutisht, përmbajtjes së marrëveshjes, sepse është tagër i tjetërkujt, por ajo që ne kujdesemi të bëjmë në këtë komision është nëse gjithçka është konform Kushtetutës. Ratifikimi që ne bëjmë si parlament i jep mundësi ndryshimeve në këto marrëveshje, që ato të marrin fuqi ligjore, pra, fuqi ekzekutive. Kjo marrëveshje, në radhë të parë, kjo nuk ka të bëjë me këmbimin e mallrave bujqësorë, por ka të bëjë me këmbimin e mallrave industrialë, natyrisht, lejohen edhe ato bujqësorë.

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Lexojeni krijimin e EFTA-s, sepse është mirë që nga çdo mbledhje komisioni të dalin e të kuptojmë se çfarë jemi duke diskutuar. Këtu ngrihet një diskutim krejt tjetër.

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Dhurata, unë dëgjova këdo dhe nuk ndërhyra. Unë nuk jam dhe nuk besoj se ndonjëri këtu është ekspert i marrëveshjeve të tregtisë së lirë. Ne jemi Komision i Ligjeve dhe si Komision Ligjesh kemi tjetër kompetencë dhe tjetër tagër dhe le t'u përmbahemi atyre. Në një rast tjetër, në qoftë se dokumentet nuk do të na ishin vënë në dispozicion, do të isha tërësisht dakord me diskutimin e zotit Alibeaj që dokumentacioni në Kuvend do të vijë i plotë, por dokumentacioni ka ardhur i plotë, sepse edhe marrëveshja që ju cituat është që pse është vetëm në shqip? Ka ardhur në shqip, sepse marrëveshjet në anglisht i shkojnë Komisionit të Integritetit dhe nuk i shkojnë çdo lloj komisioni parlamentar, por, në qoftë se ju e doni edhe në anglisht, unë nuk besoj se ky është problemi më i madh që ka ky komision.

Nga ana tjetër, duhet të mos harrojmë që ne jemi përfaqësues të qytetarëve dhe është e rëndësishme që ata sot të kuptojnë se çfarë do të sjellë kjo marrëveshje në interesin e tyre, gjë që, në fakt, nuk po bëhet me dije, për shkak të ndërhyrjeve dytësore, dokumentacioni kjo, apo

ajo, pa e ditur se çfarë është EFTA dhe kush e ka krijuar EFTA-n. EFTA, në fakt, është një bashkësi e vendeve europiane, çfarë lidhje ka Egjipti me EFTA-n?

Klotilda Bushka –Kolegë, kush është dakord me projektligjin në parim të projektligjit “Për disa shtesa në ligjin nr.99/2021, “Për ratifikimin e vendimit të komitetit të përbashkët EFTA – Shqipëri nr.1 i vitit 2021, miratuar më 24.06.2021, për ndryshimin e protokollit b të marrëveshjes së tregtisë së lirë, ndërmjet shteteve të EFTA-s dhe Republikës së Shqipërisë, lidhur me përkufizimin e konceptit të “Produkteve Origjinuese” dhe metodat e bashkëpunimit administrativ, dhe ndryshimin e marrëveshjeve për bujqësinë ndërmjet Republikës së Shqipërisë dhe Konfederatës së Zvicrës, dhe Republikës së Shqipërisë dhe Republikës së Islandës, si pjesë përbërëse e saj”? Janë të gjithë pro. Kundër nuk ka. Abstenim nuk ka.

Neni 2. Dakord të gjithë. Kundër nuk ka. Abstenim nuk ka.

Miratohet.

Neni 3. Dakord të gjithë. Kundër nuk ka. Abstenim nuk ka.

Miratohet.

Kush është dakord në tërësi me projektligjin? Dakord të gjithë. Kundër nuk ka. Abstenim nuk ka.

Miratohet.

Ju falënderoj, kolegë!

Për mbledhjen e radhës do të njoftoheni.

MBYLLET MBLEDHJA